

**KOMISIONI I PËRBASHKËT I SHQIPËRISË DHE I KOSOVËS  
PËR MIRATIMIN E TEKSTEVE MËSIMORE PËR DIASPORËN**

**VENDIM**

Nr. 2, datë 13.12.2022

**PËR**

**MIRATIMIN E PAKETËS SË DOKUMENTEVE PËR  
PROCEDURËN E ZHVILLIMIT TË KONKURSIT TË TEKSTEVE  
MËSIMORE PËR DIASPORËN, NIVELI II DHE NIVELI III**

Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe i Kosovës për miratimin e teksteve mësimore për diasporën (në vijim Komisioni i Përbashkët), i krijuar në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, "Për organizimin e përbashkët të mësimin të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë", datë 23.03.2015, e lidhur në Tiranë, ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Diasporës të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, bazuar në Vendimin nr. 756, datë 23.09.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për funksionimin e Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën", Vendimin nr. 2-1151, datë 7.07.2020, "Për emërimin e grupit të punës", të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Kosovës, Urdhrit nr. 686, datë 15.11.2022, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, "Për caktimin e përfaqësuesve të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe botimit për diasporën në Komisionin e Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore të Përbashkëta për Diasporën",

**VENDOSI:**

Miratimin e "Paketës së dokumenteve për procedurën e zhvillimit të konkursit të teksteve mësimore për diasporën, niveli II dhe niveli III", bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

## KOMISIONI I PËRBASHKËT

Znj. Anila Ferizaj



Z. Arbër Salih

Z. Ymer Avdiu



Znj. Erida Koleci

Znj. Ardjana Gjini




Znj. Shqipe Gashi-Ramadani



Z. Isni Kryeziu

Znj. Feime Llapashtica Lipscomb



Znj. Evis Mastori

Znj. Mimoza Hysa Çuliqi

